

RRETH IMAZHIT TË SHQIPTARIT NË KRIJIMTARINË ARTISTIKE E PUBLICISTIKE TË ERNEST KOLIQIT

Laura SMAQI

Departamenti i studimeve letrare, Qendra e Studimeve Albanologjike,
Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë,
SHQIPËRI

E-mail: laurasmaqi@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Në punimin tonë jemi përqendruar në disa aspekte të fizionomisë së shqiptarit që zbulohen e janë në qendër të prozës së shkurtër si dhe artikujve publicistikë të Ernest Koliqit. Tipare si: bashkëjetesa e besimeve (më konkretisht atij të krishterë dhe atij pagan); roli mbizotërues i kodit zakonor në jetën shoqërore e pamundësia e individit për të qenë vetvetja; raporti mes traditës dhe risisë në mendësinë shqiptare të viteve '30 të shekullit të kaluar; tipare psikologjike tipike të karaktereve të vëna në fokus si përfaqësues të mjedisit të kohës, (në mënyrë të veçantë të tregtarit e të studentit që kthehet nga vendi i huaj ku studion në vendlindje, aty ku ka kujtimet më të dashura të fëmijërisë) etj. Hetimi i pavetëdijes është po ashtu pjesë e pandashme e procesit artistik të autorit. Përfaqësues i krijimtarisë artistike me atë publicistike vë në dukje faktin që si trajtimi artistik, ashtu dhe qëndrimi i drejtpërdrejtë i autorit synojnë ta bëjnë lexuesin të vetëdijshëm për rëndësinë e njohjes së vetvetes jo thjesht si individ, por si pjesë e etnisë së cilës ai i përket.

Fjalë kyçe: Koliqi, prozë e shkurtër, psikologji etnike, kod zakonor, gjakmarrje, e pavetëdijshmja, procesi i njohjes.

HYRJE

"Lypet një studim bukur i gjatë e i kujdesshëm i psykes shqiptare. Duhet bërë analiza e fijeve më të imta të vetive tona për të depërtuar në palcin e mystershëm të jetës së kombit nëpër spastrim të sovrastrukturave, të dreckave e të ndryshkut mbrënda t'cilve ai palcu mbështuell e u mshef prej fatkeqsis së rrethanave historike. Duhet të njohim qenësin (esence) më të thellë të fisit (racë) për të gjetë vijat e arkitekturës shpirtnore qi i lypën një atdheut vërtet shqiptar..." (Shejzat, 1960, nr. 5-6, f.146)



Kështu do të shkruante Koliqi në *Shejzat*, por jo vetëm aty. Në pjesën më të madhe të shkrimeve të tij publicistike ai do ta shprehte qartë domosdoshmërinë e gjetjes së thelbit të shpirtërorësisë etnike, pikërisht atë që ka synuar të realizojë gjatë gjithë krijimtarisë së tij artistike. Zbulimi i tipareve më qenësore të fizionomisë së shqiptarit, si hapi më i rëndësishëm i njohjes së vetvetes është sheshimi i vazhdueshëm i gjithë krijimeve të Koliqit. Më poshtë do të përmendim përmbledhtas disa ele-

mente të kësaj fizionomie, të trajtuara në tregimet e novelat e tij.

1. Bashkëjetesa e besimeve

Një varg tregimesh të *Hijes së maleve* zbulojnë praninë dhe rëndësinë e krijesave mitologjike, zana e orë në besimin popullor shqiptar. Ato janë pjesë e jetës, ekzistenca e tyre nuk mund të vihet në dyshim, po ashtu ato luajnë rol në forcimin e lidhjeve të shqiptarëve me tokën e gjithçka të mirë që kanë ruajtur përmes traditës. Tek *Nusja e mrekuellueshme* mjaft interesant është fakti që gjindja e malësorëve besimtarë që del nga kisha, megjithëse ndjek ritet fetare të krishtera, nuk dyshon për asnjë moment në ekzistencën e Zanës, e në fuqitë e saj.

Po ashtu kaçakët *Kur orët lajmojnë*, shkojnë e rrëfehen pasi kanë marrë lajmin e vdekjes së afërt të njërit prej tyre nga oret e malit. Historia e *Zanës së fundme* tregohet në një familje që i takon besimit islam. Edhe këtu, ku personazhet janë qytetarë, dhe lidhjet me natyrën janë disi më të largëta, e më të distancuara besimi në zana konsiderohet si pjesë e traditës dhe nuk shkon aspak ndesh me jetën reale të tyre.

Kjo bashkëjetesë besimesh (të krishterë, islam) me besimin pagan, e vënë në dukje artistikisht prej Koliqit, është tipar mjaft i pranishëm në mendësinë shqiptare. Duke qenë në thelb pagan, shqiptari jo vetëm ka besuar në zana e orë, por i ka konsideruar ato si hyjni kombëtare, si të krijuara nga qielli e toka shqiptare, si pjesë të shpirtit të tij. Krishtërimi e islami, si besime që dilnin jashtë kufijve të botës shqiptare e që në një farë mënyre na afronin me vende të tjera, na fusnin në hapësira shumë më të gjera, na bënin pjesëtarë të një shumësie, nuk mund të shmangnin besimin pagan, frut i lidhjes së drejtpërdrejtë të shqiptarit me mjedisin ku ai jetonte.

2. PUSHTETI I KANUNIT

Kodi zakonor ka zgjuar që herët vëmendjen e Koliqit me tërësinë e aspekteve që ngërthen e me fuqinë thuajse absolute të tij. Ashtu si mitologjia, edhe ai është shprehje e një stadi primitiv, ruajtur dhe transmetuar deri në ditët e sotme përmes traditës, duke vepruar si rregullator marrëdhëniesh shoqërore që ka si synim vendosjen e raporteve

të ekuilibruara mes anëtarëve të një bashkësie. Lidhja e pandashme që këto dy sisteme kanë me traditën, si dhe fakti që ndihmojnë të zbulohen tipare tipike të fizionomisë shqiptare me të mirat e të këqijat që mbartin në vetvete, janë arsyt kryesore që shtojnë Koliqin t'i fokusojë në krijimet e tij. Dy aspektet më tipike të Kodit zakonor; besa e gjakmarrja, që njëkohësisht përcaktojnë edhe tiparet më thelbësore të psikologjisë së shqiptarit, i gjejmë të trajtuara artistikisht në tregimet e novelat e Koliqit.

Institucioni i mikut dhe i besës përfaqsojnë anën e ndritshme jo thjesht të kodit, por dhe të sjelljes shqiptare. Tregimi *Miku* në mënyrë mjaft lakonike, jep atmosferën e jetës së një gjakhupësi, që njëherësh është dhe toger që synon të ngrihet në detyrë. Gjakësi i vëllait bashkë me armikun e qeverisë, të cilin ai ka urdhër ta kapë i shkojnë miq në shtëpi, e të gjitha synimet e tij si për të marrë gjakun, si për të kapur gazetarin kthehen në kështjella rëre, ai i ka ata aq afër dhe më larg se kurrë. Në shtëpi të tij ata janë më të mbrojtur se kudo. Kanuni ndërhyr, jo vetëm me ligjet e tij që përcaktojnë sjelljen e individit, por dhe me mënyrën e formën e të shprehurit, me formulat karakteristike. Ai është pjesë jo vetëm e jetës malësore, por dhe e ligjërimit.

Me lakonizmin e tij tipik kodi "ndërhyr" në universin e brendshëm artistik, duke bërë që të mos ketë asgjë të tepërt. Çdo paragraf, çdo frazë është ndërtuar me një thjeshtësi e fuqi shprehëse të veçantë që reflekton tiparet e ligjërimit malësor.

Formulat miqësore të shprehura shoqërohen me një gjendje tepër të vështirë shpirtërore, që është e kundërt me fjalët që artikulojnë. Absurditeti i rrethanës shoqërohet me formula po aq "absurde" po të kesh parasysh marrëdhëniet mes dy malësorëve si dy njerëz që janë "në gjak".

Gjoka i thotë gjakësit: "*Zoti të rritë oxhakun Uç Lleshi*" ose "*Zoti të rritë jetën*".

Uci i përgjigjet: "*Kjofsh me jetë e e mira të gjetë...*", ndërkohë që një vend i nderuar për secilin në rrethin ku jeton nënkupton dhe ka si parakusht të domosdoshëm eliminimin e tjetrit.

Një ndjenjë e thellë admirimi shoqëron tërthorazi tregimin. Ajo lidhet me bindjen se res-

pektimi i disa normave që e lartësojnë njeriun, e ngrenë atë mbi vetveten e pasionet e tij duhet vlerësuar. Një sakrificim i tillë i personales për hir të diçkaje që qëndron mbi individin, është për Koliqin jo vetëm për t'u admiruar e vlerësuar, por dhe për t'u ruajtur si diçka tepër e rëndësishme në tërësinë e vlerave tona si shqiptarë.

"Ndër 30 e ca vjet qì jap mësim...në kanu e në tradita stërgjyshore të Shqipnis gjata argumentat e përshatshëm mëe ba të kuptueshme botën shqiptare... Po nuk e lidhëm krenin e emnin shqiptar me besë, nderë, burrni, mikpritje, d.m.th. me trashëgim stërgjyshuer, sa për vetina tjera cilat do qofshin, na rradhitemi në bisht të kombeve t'Europës... Kur tham kanuni e kam fjalën te fryma e kanunit, jo te shumica e normave arkaike të tija, disa prej të cilave sot s'kanë vështrim. Ku gjen nji nderim për vetjen njerëzore si në dokat shqiptare, ku mprohet grueja ma tepër se në kanu. Po demokracia e thellë e rranjosun para kryengritjes frënge në shpirt të shqiptarit? ... Janë parime të nalta plot fisniki njerzore" (Shejzat, 1971, nr.4-6).

"Nuk lëvdoj gjakmarrjen qì ka damtue tmerisht kombin, çmoj ndiesit kalorsiake, qì përsjellshin nji vrasje kur kjo kryhej në stihimin e ndiesis së nderit, por jo vrasjen. Ndjesia asht për t'u lëvdue, pasoja qì ajo shkakton duhet dënue rrebtësisht. Normat e kanunit koha i kapërcei, po dam të madh do pësonte shpirti shqiptar ditën qì fryma thellësisht shqiptare e ligjeve dokesore mos të lëvritte në të." (Shejzat 1965, nr. 1-2).

Novela Gjaku fuqinë e kodit zakonor e bën akoma më të dukshme. Fakti që një mësues që ka si ideal zhdukjen e gjakmarrjes ndër brezin e ri përmes edukatës, kthehet vetë në gjakmarrës, tregon jo vetëm një gjendje shoqërore të një periudhe të caktuar, por dhe vështirësinë e pamundësinë e njeriut për të qenë individ në shoqërinë shqiptare. Mendimi personal është gjithmonë i kushtëzuar prej mjedisit, është i pa peshë. Karakteri i fortë konservativ i normave zakonore u jep atyre fuqi gati hyjnore, i jep pushtet absolut. Duke perifrastuar fjalët e Koliqit në gazetën *Vullneti i popullit* në artikullin "Letër e hapun të Ndertit At Cordignano mbi kritikën për novelën *Hija e Maleve*" (*Vullneti i popullit*, 14.III.1930, f. 3) ambienti turbullon e nxjerr jashtë vetes edhe njeriun më të përgatitun për t'i bërë ballë. "Novela mund të kishte për nëntitull frazën proverbiale

shkodrane: "Ma i zi gërgasi se dorasi". Jemi të një mendjeje me Sabri Hamitin i cili shprehet:

"Në këtë shpalim etno-psikologjik, Ernest Koliqi si mjeshtër i madh i letërsisë etnike e të zakoneve shqiptare, mbetet i paanshëm: ai vetëm përpiqet të shfletojë të gjitha kindet e jetës, për të parë domosdotë e trajtave të saj. Në aspektin njohës të kësaj jete, ai në novelën e vet jo vetëm që sugjeron, po edhe tregon se jeta shqiptare zhvillohet në një diversitet të madh, gati e papajtuueshme tërësisht për asnjë çështje... Koliqi përfundimisht sugjeron se në Shqipërinë e viteve njëzet – tridhjetë vdesin apo shprishen heronjtë e kulturës" (Hamiti, 2002: 602-603).

3. FIGURA E KARAKTERE QË JANË PJESE E REALITETIT TË RI TË VITEVE '30

Një prej figurave që merret e rimerret në disa tregime është studenti që kthehet pas një mungese të gjatë në qytetin e tij të lindjes, me mall dhe me një ndjeshmëri të veçantë, bashkë me dëshirën për të ringjallur të shkuarën, parajsën e tij të humbur.

Ditëve të korrikut personazhi që herë quhet Shuk, herë Lec, shkon për vizitë, herë në shtëpinë e kushërinjve më të dashur, dhe herë tek nënëdaja, sepse këto janë vende ku të dy ka kaluar çastet më të bukura të fëmijërisë. Të duket se ke të bësh me një personazh që në dy momente të ndryshme mundohet të bëjë të njëjtën gjë, të ringjallë kohën e shkuar të fëmijërisë.

Nëpërmjet tyre autori do të tërheqë vëmendjen se është krijuar dhe po krijohet një shtresë të rinjsh të shkolluar, të cilët për shkak të formimit e të një sërë faktorëve, janë individë shumë më të ndieshëm e më analitikë se masa e gjerë. Këtë prirje ata e zhvillojnë së pari me vetveten, të shtyrë nga dëshira për t'u njohur sa më mirë, jashtë klisheve dhe përgjithësimeve pa vend. Ky tip i ri intelektual, është pjesë e një realiteti bashkëkohor, që ndërthuret me aspektet e trashëguara, duke e bërë më interesant portretin e përgjithshëm psikologjik të shqiptarit.

4. FIGURA E TREGTARIT

Tregtari, si figura më interesante dhe komplekse e këtij realiteti të ri, zë vend në disa tregime, ku shihet nga kënde të ndryshme. Në realizimet më të mira ai është tregtar simbolesh e

ëndërrash *Tregtar famujsh e Djepi arit*, në të tjerat është idhnaku që konsideron herezi gjithçka që del nga koncepti i tij i jetës i ngritur mbi paranë. Që në titull *Tregtar flamujsh* tërheq vëmendjen për praninë e diçkaje të pazakontë. Semantikisht, dy përbërësit janë të papajtueshëm. Tregtari është një njeri që blen e shet mall, flamuri është simbol. Ndërsa i pari nuk mund të kuptohet pa materialen, të cilën e ka të vetmen fushë konceptore, flamuri e përligj ekzistencën e tij vetëm si simbol. Sidomos tek ne, si pasojë e rrethanave historike, ai gjithmonë është veshur me një ngjyrim me emocionalitet të lartë.

Vënia pranë e dy elementeve (tregtarit dhe flamurit), duke qenë se secili i takon një fushe semantike të ndryshme që përjashton tjetrën (siç është lëndorja me abstrakten), të bën të mendosh një lidhje figurative, ku elementet e njëres fushë i vishen tjetrës. Ose tregtari nuk është tregtar, ose flamuri nuk është i tillë. Në të vërtetë tregtari është i tillë deri në ekstrem, edhe flamuri është realisht i pranishëm, por jo në rolin që i takon, ai është shndërruar në objekt, në mall.

Anmiku në shtëpi kontrastin mes thelbit dhe shfaqes e zbulon nëpërmjet mospajtimit mes fetarit të përshpirtshëm dhe atij që urren dikë, thjesht se nuk i përshtatet mendësisë së tij, shkallës së tij të vlerave. *Vena shtatëveçe* shfaq një tjetër tipar karakteristik të tregtarit, kopracinë dhe dyfytërsinë në raport me familjen dhe rrethin shoqëror.

Hetimi i pavetëdijes është ndër risitë më të rëndësishme që solli Koliqi me tregimet e novelat e tij. Duke e konsideruar si një ndër aspektet themelore të procesit të njohjes së vetvetes, ai bashkon e gërsheton aspektin individual, hetimin e karakteristikave të personazheve të tij, me nxjerrjen, vënien në dukje të asaj që na dallon si shqiptarë nëpërmjet hetimit të nënvetëdijes kolektive, pjesë e thelbit etnik shqiptar.

“Vërte punë tejet e tërhyjekëshme ushtrimi i zejes së shkrimit në rrethin shqiptar. Gjindesh përpara një bote virgjine, e shkopueme nga lakmimi afshuer me njoftë vetoeten, një botë qi pret e kërkon interpretat e hollë e të fuqishëm njiherit të vlerave të saja njerzore dhe ethnike. Përvoja e breznive të kalesës ruejtë në shkulma të gjakut nëpër rrjedhje të shekujve lypë një vlerësim, vumja në spikamë t’ethos – it kombtar, pasuni e mysterëshme

strukë në nënvetëdijen kolektive ku lëvizin thasaret e brumit të rodit arbnuer ngjeshë në magje t’historis, don të shfaqet nëpërmjet shkrimtarit – lajmtar, mishnimi i amshuem i vetive të kombit qi përtrihet prej etënvvet nëpër bij e nipa ka nevojë m’u gdhenë lumnisht në vepra arti e letërsie.” (Shejzat 1970, nr.1 – 3. f.388)

Në shumësinë e artikujve të botuar kryesisht tek *Shejzat* Koliqi zbulon mjaft aspekte të tjera të cilat herë kanë zënë vend e herë jo në tregimet e novelat e tij. Në artikullin “E bukura e dheut”, *Shejzat*, 1958, nr. 1-2 do të shprehej:

“Na Shqiptarët, me at natyrë të ndërlikueme qi kemi, luhasim shpirtnisht në mes dy polesh kundërshtare. Jemi të shoqueshëm, mbliidhemi me knaqje, por një neps i paspjeguem i mbrëndshëm na shtyn shpesh me prishë – arsye e pa arsye – shoqin. Fjala e vrashtë, vërejtja therce na del vrik e vrik nga goja. Shokun mâ të ngushtë, mikun mâ të dashun deshirojm t’a mudojmë, tue prekë e lëndue në biseda të kota, pa qellim, fije intime të jetës a të shpirtit të tij. E shtrëngojmë edhe tjetrin me veprue, po n’at mënyrë. Kështu qi shpesh mbledhjet edhe miqsore shqiptare nuk janë tjetër veç një ushtrim torture morale të ndërmjetoeshme, në të cilën çdo pjesëmarrës orvatet të gjëje shprehe sa mâ shporuese për me zëmru e cenue tjerët. E, prá të Parët t’onë nuk duket se e kishin kët ves të mbrapësht. Ndër ta burruja e njerzija shkojshin çift. U vritshin, por nuk u shájshin në mes vetes. Si mund të përtrihet në shoqin shqiptare harmonija ringjallse, sheruese, frytdhânse? Si mund të shuhet vala e egersis qi hov hov na kapë e na shndrron në mizorë të vetvetes dhe të tjerove? Si mund të kërthndezet në shkulma të gjakut t’onë të paqetë lulja fisnike e njerzis?” (“E bukura e dheut”, *Shejzat*, 1958, nr. 1-2, E.Koliqi, *Vepra* 6, Faik Konica, Prishtinë 2003, f.16-17).

Si njohës mjaft i mirë i psikologjisë dhe mjedisit shqiptar, malësor e qytetar, ai do të shprehej disa herë për kulturën e mungesën e saj, e sidomos për kulturën e vërtetë dhe gjysmake. Për Koliqin kultura është shkrirja e intuitës natyrore me dijen që përfitohet nga studimi. Për pasojë ai vlerëson shumë më tepër zgjuarsinë natyrore të malësorëve, sesa kulturën e mangët. Vlerësimin për këtë aspekt ai do ta shprehte artistikisht që në vëllimin e parë të prozave, në *Hijen e maleve*, në tregimin *Se qofsh pleqnofsh*. Është lënë krejtësisht mënjanë tragjedia e shuarjes së dy jetëve për të

vënë theksin në gjykimin e urtë të pleqve. Është aftësia e mprehtë analizuese e malësorëve dhe në raste të koklavitura si dhe fryma “kalorsiake” e kanunit ato që mrekullojnë autorin. Të dy këtë aspekte ai i sheh si cilësi tepër me vlerë, që qëndrojnë mbi tragjeditet personale dhe janë shprehje e inteligjencës tipike shqiptare. Drejtpërdrejt ai do të shprehej:

“Ka ndër male e ndër fusha të Shqipnis burra me mend, qi s’dijnë as me këndue as me shkruë, të cilët, pajisë me kthjellti gjikimi e me hollsi depërtuese, pleqnojnë, mbrënda rrethit të së drejtës dokesore e të shpirtit gojdhânuer të trashiguem me një urti qi lën pamënd juristin mâ të pregatitun dhe dijetarin mâ të rrahun në spekulime filozofike. Kjo mrekulli ndodhë sepse ata themelohen në visar parimesh mijavoçare të stërgjyshave, qi, tue e lëshue në thellsi të pellgut të jetës, u a mban menden të ngulun e të patrandun midis valavitjes së thânethaçave lara – lara t’atyne qi përdorin tulin e gjuhës pa e lidhë me punën e fijeve të trûnit. Po e njëjta urti i shtyn mos me dalun jashta megjeve të kuptimit të tyne.” (“E qenmja dhe të dukun”, *Shejzat* 1958, nr. 3-4. E.Koliqi, *Vepra* 6, Faik Konica, Prishtinë 2003, f. 19.) Domosdoshmëria e trajtimeve psikologjike në letërsi është theksuar e përsëritur mjaft herë prej Koliqit si një prej deyrave më të rëndësishme të shkrimtarit. Njohja e psikologjisë etnike i është premisë e nevojsjme e i shërben sipas tij zhvillimit mendor e kulturor të vendit.

“Si fitohet vullndesa e zotësija për me shfrytëzue krojet e pasunis qi natyra na fali?”

Vetëm tue analizue virtytet e veset e kombit në mënyrë qi të dijmë ç’farë masash të marrim për me forcue të parat e me shrrânjosë të dytat.

Diagnozën e shpirtit të një kombit e bân letrësija.

*E thotë një dijetar qi si të njihet mirë smundja gjetja e mjekimit bâhet punë e lehtë.” (“Misjoni i letrarve të rinj shqiptarë”, Leka, 1931, nr. 2. E. Koliqi, *Vepra* 5, Faik Konica, Prishtinë 2003, f. 293.)*

“Misjoni i të rrijve âsht me vijue ata udhë qi hapën të Mëdhajt, me studjue thellë psikologjin e panjohun të rracës s’onë dhe me u dhânë zhdriovillim problemeve të gjalla shpirtënore të jetës s’onë të përditëshme.” (Po aty, f.297)

“Pak janë vëndet e botës qi u paraqesin letrarve, për ushtrimin e artit të tyne, lâ më aqë të hapta sa Shqipnija. Shqipnija âsht një mozaik zakonesh të ndryshme e t’interesueshme.” (Po aty, f.299)

U munduam të vemë në dukje disa tipare të psikologjisë së shqiptarit që zenë vend më të dukshëm në krijimet e publicistikën e Koliqit. Si një prej autorëve më me peshë për kohën, si në Shqipëri gjatë viteve 30, ashtu dhe në diasporë deri më 1975, ai e konsideronte mjaft me rëndësi punën për ndriçimin e këtij aspekti, që do të ishte baza mbi të cilën do ngrihej gjithë veprimtaria e mëpasme në fushën e shqiptarizmit. Edhe sot idetë e tij mbeten jo vetëm aktuale, por për fat të keq dhe akoma të pa kapërcyera.

BIBLIOGRAFI

HAMITI, S. (2002), *Letërsia moderne, vepra letrare* 8, Faik Konica, Prishtinë.

KOLIQI, E. (1929), *Hija e maleve*, Zara.

KOLIQI, E. (1935), *Tregtar flamujsh*, Shkodër, Shtypshkronja e Zojës së mirë.

KOLIQI, E. (2003), *Vepra* 1-6, Faik Konica, Prishtinë.

KOLIQI, E. (1930), “Letër e hapun të Ndertit At Cordignano mbi kritikën për novelat “Hija e Maleve”, *Vullneti i popullit* 14. III 1930: 3.